



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2019:247827

Datë: 15.07.2024

Numri i dokumentit: 05940007

**C.nr.410/19**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË SKENDERAJ**, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Nderim Musa, në çështjen juridike kontestimore të paditësit I.Th., nga fshati..., Komuna e Skenderajt, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Q.R., avokat në Skenderaj, kundër të paditurit F.Th., nga fshati..., Komuna e Skenderajt, me objekt kontesti, vërtetim pronësie, jashtë seance, me datë **15.07.2024**, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**KONSIDEROHET** e tërhequr padia me numër C.nr.410/19, e paditësit I.Th., nga fshati..., Komuna e Skenderajt, kundër të paditurit F.Th., nga fshati..., Komuna e Skenderajt, lidhur me çështjen vërtetim pronësie, për mospagesën e taksës gjyqësore.

**A r s y e t i m**

Paditësi përmes të autorizuarit të tij ka ushtruar padi në këtë gjykatë, kundër të paditurit për vërtetim pronësie.

Gjykata me aktvendimin C.nr.410/19, i datës 28.05.2024, ka kërkuar nga paditësi që t'a paguajë taksën gjyqësore për padi në shumë prej 100.00 Euro, me vërejtje se padia do të konsiderohet e tërhequr nëse nuk veprohet konform vërejtjeve të dhëna si në aktvendim.

Nga fletëkthesa konstatohet se i autorizuari i paditësit aktvendimin për pagesën e taksës gjyqësore e ka pranuar me datë 29.05.2024, ndërsa nuk ka bërë pagesën e taksës gjyqësore as deri me datën 15.07.2024, si datë e nxjerrjes së këtij aktvendimi, për më shumë se 2 (dy) muaj e gjysmë.

Gjykata pagesën e taksës gjyqësore e ka pritur përtej afateve ligjore, andaj, meqenëse paditësi nuk ka vepruar konform aktvendimit dhe vërejtjeve të dhëna, për të paguar taksën gjyqësore

gjkata konform nenit 253 par. 5 të LPK-së, lidhur me nenin 5 paragrafi 5.5 pika 5.5.2 të Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË SKENDERAJ**

**Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil**

**C.nr.410/19, të datës 15.07.2024**

Gjyqtari  
Nderim Musa

---

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.